REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDIM

Nr. 10, datë 07.06.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "PISTË PËR FLUTURIME TË LIRA, ME VELA PA MOTOR", NË PARKUN KOMBËTAR TË DAJTIT, BASHKIA TIRANË"

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me subjekt kërkues Federatën Shqiptare të Aeronautikës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: "Pistë për fluturime të lira, me vela pa motor", në Parkun Kombëtar të Dajtit, Bashkia Tiranë", me subjekt kërkues Federatën Shqiptare të Aeronautikës.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT